

VENDIM
Nr. 27, datë 20.4.2018

PËR MIRATIMIN E “KODI ETIK I KRYETARIT DHE DREJTUESVE TË LARTË TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT”

Bazuar në nenet 162/1, 163 dhe 164 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 25, pika “a”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI të INTOSAI-t, sidomos në Standardin ISSAI 30 “Kodi i Etikës” dhe në Standardin ISSAI 12 “Vlerat dhe përfitimet e institucioneve supreme të auditimit - të bësh diferencën në jetën e qytetarëve”, me qëllim plotësimin integral të Kodit të Etikës së Kontrollit të Lartë të Shtetit,

VENDOSA:

Miratimin e Kodit Etik të Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të KLSH-së, si përmbledhje e tri dokumenteve kryesore:

Kodit të Etikës së KLSH-së;

Kodit të Sjelljes së Deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë; dhe

Standardet Ndërkombëtare të auditimit suprem publik, ISSAI-t, në veçanti, ISSAI 30 “Kodi i Etikës” i INTOSAI-t.

Neni 1

Kodi Etik i Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të KLSH-së, si trupa drejtuese e institucionit që duhet të përcjellë vlerat më të larta dhe të realizojë misionin e kësaj strukture kushtetuese, miratohet dhe hyn në veprim me synim forcimin e mëtejshëm të integritetit dhe transparencës së institucionit suprem të auditimit, i cili drejton nëpërmjet shembullit, mbi bazën e parimit ndërkombëtar “tone at the top” (përgjegjësia në radhë të parë të drejtuesit). Ai mbështetet në tri dokumente kryesore:

i. në Kodin e Etikës së Kontrollit të Lartë të Shtetit, të miratuar me vendim të Kryetarit të KLSH-së nr. 56, datë 30.4.2015;

ii. në Kodin e Sjelljes së Deputetëve të Kuvendit, miratuar me vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr. 61, datë 5.4.2018; dhe

iii. në Standardet Ndërkombëtare të auditimit suprem publik, ISSAI-t.

Neni 2

Kodi Etik i Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të KLSH-së është plotësim integral i Kodit Etik të institucionit, kreu “Dispozita të Përgjithshme”, neni 4, pika 4.3.

Neni 3

Kryetari i KLSH-së, sekretari/drejtorët e Përgjithshëm, drejtorët e departamenteve/ drejtorive dhe Kryeaudituesit njohin dhe zbatojnë pa asnjë kusht, me rigorozitet dhe përpikëri Kodin e Sjelljes së Deputetëve, miratuar me vendim të Kuvendit të Shqipërisë nr. 61, datë 5.4.2018 “Për miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”, punuar me ekspertë të OSBE-së, si një ndër standardet më të larta në vend dhe etalon të sjelljes etike të një nëpunësi të Shtetit, zbatimi i të cilit i mundëson institucionit dhe ekipit drejtues të tij një imunitet të fortë ndaj konfliktit të interesit dhe sjelljeve në dëm të interesave të qytetarit.

Neni 4

Kryetari i KLSH-së, në ndjeshmëri të lartë dhe përgjegjshmëri maksimale ndaj pasojave të problematikës që paraqitet përpara titullarit të një institucioni kushtetues të pavarur që mund të rikandidojë për pozicionin që mban, problematikë e cila rrezikon të cenojë pavarësinë e institucionit të pavarur kushtetues që ai drejton, e deklaroi publikisht përgjatë viteve që ushtron aktivitetin synimin dhe vullnetin e tij për të mos rikandiduar, si dhe katër muaj përpara datës së mbarimit të afatit të qëndrimit në detyrë, i adreson zyrtarisht Presidentit të Republikës kërkesën për mos rikandidim për t'u rizgjedhur Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, duke jua bërë me dije edhe Kryetarit të Kuvendit dhe Kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave të Kuvendit.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kodi Etik i Kryetarit dhe Drejtuesve të Lartë të KLSH-së lexohet dhe zbatohet integralisht në të tria dokumentet e cituara në nenin 1 dhe në këtë vendim.

KRYETAR
Bujar Leskaj